



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-5121

Dt.07.04.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Bajram (Teki) Qela** nga Gjakova, për dhënen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim: Objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese, me etazhitet P+5– **FAZA E PARË, etazhiteti për këtë fazë është P+2** në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: aplikuesit: Bajram (Teki) Qela nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim - objekt banimor shumë banesor me afarizëm në përdhese– **FAZA E PARË**, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urbanistik “Jugu A dhe Jugu Ana Lindore” dhe, Kushtet Ndërtimore për rregullimin e hapësirës, me nr. 07-351-1604, dt.21.02.2017, të lëshuara nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 2517/1, ZK: Gjakovë - Qytet, në rrugën “Ali Pashë Tepelena”, në pronësi të të lartëpërmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i tërësishëm i objektit është P+5, ndërsa etazhiteti i objektit për **FAZËN E PARË është P+2**, në sipërfaqe të përgjithëshme (bruto) te objektit për këtë fazë prej **S=140 m²**

Përdhesa:	(Sip,Bruto):	S=43.00 m ²
Kati i parë:	(Sip,Bruto):	S=48.50 m ²
Kati i dytë:	(Sip,Bruto):	S=48.50 m ²

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit shumë banesor me afarizëm në përdhese, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese ndërtimore “Real – PROJECT”- Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkrar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë për Punë Inspektuese, për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të lokacionit të piketuar.
- Për Objektet e kategorisë së dytë, Investitori duhet që për secilën fazë të ndërtimit, të parashtojë kërkesë, pranë Drejtorisë për Punë Inspektuese, me qëllim të Inspektimit dhe përcjelljes së realizimit të punimeve nga secila fazë, si dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e Certifikatës - Lejes së Përdorimit të objektit.

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Bajram (Teki) Qela nga Gjakova, me banim në rrugën "Ali Pashë Tepelena" nr.13, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-5121, të datës 13.03.2017 për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim: Objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese, me etazhitet P+5– **FAZA E PARË, etazhiteti për këtë fazë është P+2**, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 2517/1, ZK: Gjakovë - Qytet, në rrugën "Ali Pashë Tepelena", në pronësi të të lartëpërmendurit, siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 , të datës 24.01.2017, i vërtetuar nga "GEO-REJ" SHPK.
2. Kopjen e planit të datës 20.01.2017, në pronësi të Bajram (Teki) Qela, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me nr. të lëndës 235/17, dt. 20.01.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Pëlqimin nga Banka për Biznes, me nr. D360, dt. 22.03.2017,
5. Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-1604, dt. 21.02.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit banimor shumë banesor, në ngastrën kadastrale me nr. 2517-1, ZK: Gjakovë - Qytet.
6. Vërtetimet mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë me nr. 430/a/378, të datës 13.10.2016.
7. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr. 04/17, me datë 15.03.2017, lëshuar nga Sektori i parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Gjakovë.
8. Pëlqimin Sanitar me nr. 14/530/01-5117, dt. 16.03.2017, nga Inspektorati Sanitar Komunal, Drejtoria për Punë Inspektuese e komunës së Gjakovës.
9. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 24.02.2017.
10. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A.-Gjakovë, të datës 01.03.2017.
11. Pëlqimin nga PTK-Sh.A. Gjakovë, 24.02.2017
12. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Bankën Ekonomike filiala në Gjakovë, të datës 10.02.2016.
13. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga ndërmarrja projektuese ndërtimore "Real – PROJECT"- Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 415.80 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:


Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspekcionit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur. dipl.



U.D. Drejtori
Elida Bejtullahu, inxh. e dipl. e ark.

..K. GJAKOVË

Zona kadastrale : Gjakovë-qytet

Parcela nr. 2517-1

PLAN SITUACIONI



Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Prone

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë -Qytet

Shk. zvog. 1: 500

Poseduesi: 1 /1 Çela Bajram (Teki)

Veriu



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale:

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
2517-1	-	-	Shtëpi-Ndërtesë	-	0	00	43	
2517-2	-	-	Shtëpi-Ndërtesë	-	0	00	41	
Gjithësejtë					0	00	84	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastrë duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

VËRTETON:
Arber Jusufi